



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 92/5 prot.

Tiranë, më 09.04.2021

VENDIM

Nr.36, datë 09.04.2021

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 16, DATË 24.02.2021**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 16, datë 24.02.2021, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr.16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit *****”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 431 prot., datë 26.05.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se vendimi nr. 16, datë 19.02.2020, i Komisionit të Ristrukturimit, “Për konstatimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit”, nga pozicioni “Specialist”, në Drejtorinë e Punëve Publike, Urbanistikës dhe Emergjencave Civile, është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2016, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Gjirokastër të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 217, datë 29.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit ***** dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Gjirokastër, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 217, datë 29.12.2020 si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në institucionin e Bashkisë Gjirokastër paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastër që, mbi bazën e vendimit nr. 16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, të nxjerrë aktin administrativ nëpërmjet të cilit të deklarojë lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****, për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke urdhëruar edhe dëmshpërblimin e tij sipas vjetërsisë në shërbimin civil, në zbatim të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe në aktin e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit, të shënohet në mënyrë të shprehur edhe e drejta që buron nga pika 8, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatohet se, në zbatim të dispozitivit të vendimit nr. 217, datë 29.12.2020, Bashkia Gjirokastër, me vendimin nr.17/1 prot., datë 23.03.2021, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në shërbimin civil për nëpunësin *****. Njëkohësisht, me vendimin nr.17, datë 24.02.2021, ka vendosur që, për shkak të ristrukturimit, këtij punonjësi t’i jepet dëmshpërblimi sipas vjetërsisë në shërbimin civil. Në aktin e lirimit është shënuar në mënyrë të shprehur edhe e drejta që i buron këtij punonjësi nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 217, datë 29.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 16, datë 19.02.2020, të Komisionit të Ristrukturimit, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit *****”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Gjirokastër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.217 , datë 29.12.2020.

3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Gjirokastrë dhe nëpunësi *****.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha